

## **Shpërblimi për kohën e pushimit të paguar**

*Përditësimi i fundit më 11 Mars 2025*

Në përputhje me nenin 94 të Kodit të Punës, për kohën e lejes vjetore të paguar, punëdhënësi i paguan punëmarrësit pagën që ai do të përfitonte sikur të mos kryente lejen. *Kësaj page i shtohet një shpërblim i drejtë që i përgjigjet pjesës së pagës së përfituar në natyrë.* Kriteret e përlllogaritjes së kësaj page përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 94, pika 1 e KP).

**Vlera, mënyrat dhe kriteret e dhënies së pagës në natyrë përcaktohen** me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”).

Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 22 ditë pune *gjatë vitit të punës në vazhdim.* Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, *kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës* (neni 92, pika 2, KP).

Paga që jepet për pushimet vjetore të paguara është ajo që ekziston në momentin e marrjes së tyre. Nëse paga është e ndryshueshme, paga që jepet për pushimet vjetore të paguara përlllogaritjet mbi mesataren mujore të vitit paraardhës: është e indeksueshme (neni 94 pika 2 dhe 3 i KP).